



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 60-të, të mbajtur më 28.01.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2952/1 datë 02.09.2020, ndaj personit fizik, **REFUZOHET.**

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent, sepse denoncimi nuk i përfshin personat zyrtarë.

Lënda me numër 12-2952/1 të datës 02.09.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, me datë 02.09.2020, është dorëzuar denoncim ndaj një personi fizik dhe është formuar lënda me numër 12-2952/1 e datës 02.09.2020.

Në denoncim, parashtruesi bën pretendime ndaj një personi fizik me të cilin kanë lidhje, gjegjësisht ndaj motrës së bashkëshortit të saj. parashtruesja deklaron se ajo u pasurua me paratë që i kishte lënë i ati dhe bleu shumë prona, shtëpi dhe apartamente për fëmijët e saj dhe donte të dëmtonte parashtruesin dhe fëmijët e tij. Pretendime të mëtejshme janë ngritur ndaj bashkëshortit të denoncuarit, si dhe pretendime për shkaktimin e zjarrit nga i denoncuarit.

Pas shqyrtimit të pohimeve të lëndës, KSHPK konstaton se i denoncuarit nga ----- nuk është peron zyrtar, në aspektin e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР
ПЉР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАР
Biljana Ivanovska

